



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit
P- 076/16
Prishtinë, më 23 qershor 2009, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 23 QERSHOR 2009**

Seancën e drejtoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Ibrahim Gashi**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 97 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Në fillim të seancës, për fjalë u paraqit deputeti **Dritan Tali**, i cili shprehu shqetësimet lidhur me kërcënimet që i janë bërë për shkak të diskutimit në seancën e kaluar lidhur me privatizimin në Kosovës.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 22.7 të Rregullores së Punës së Kuvendit, në marrëveshje me kryetaret e grupeve parlamentare,

në mbledhjen e mbajtur më 16 qershor 2009, ka arritur marrëveshje për formën dhe kohëzgjatjen e diskutimeve për debatin lidhur me piken e rendit të ditës, si vijon: diskutimi për deputetë të zgjatë deri në pesë (5) minuta, ndërsa për anëtar të Kryesisë, kryetar të grupeve parlamentare dhe kryetar të komisionit funksional, deri në dhjetë (10) minuta, ndërsa fjala hyrëse e ministrit e pakufizuar.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e kohëzgjatjes së diskutimeve. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për69,
Kundër.....8,
Abstenime.....9.

Kuvendi miratoi propozimin për kohëzgjatjen e diskutimeve.

Nuk pati asnjë propozim për amandamentim të rendin të ditës.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Informata për incidentin në dhomën e provave të Policisë së Kosovës

Kryetari ftoi ministrin për Punë të Brendshme, zotin Zenun Pajaziti, që para deputetëve të paraqesë informatën për deputetet e Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me incidentin në dhomën e provave në Policinë e Kosovës.

Ministri **Zenun Pajaziti** the se në bazë të raportit të Policisë së Kosovës jam informuar se natën ndërmjet 24 dhe 25 prillit 2009, persona tani për tani të panjohur, duke kaluar pengesat fizike, përfshirë murin me tela gjemborë nga ana e pasme e objektit dhe duke shfrytëzuar shkallët emergjente prapa objektit të Policisë së Kosovës, përmes derës për hyrje-dalje emergjente në katin e pestë kanë hyrë brenda objektit ku ka qenë dhoma e dëshmive. Në bazë të regjistrimit të evidencave të ruajtura nga policia, është konstatuar se me këtë rast janë vjedhur : 47 kg e 627 gram substanca narkotike të llojit heroinë, si dhe 3,828.5, 520 Rupit të Indisë, 6.5 milionë Lira të Turqisë dhe 500 Leje të Rumanisë dhe 950 Lekë të Shqipërisë.

Policia e Kosovës ka ndërmarrë një serë veprimesh operative të përcaktuara me parime dhe procedura të Policisë për sigurimin e vendit të ngjarjes ku ka ndodhur rasti dhe me qëllim të mbledhjes si dhe të sigurimit të dëshmive dhe të provave, si pjesë e procedurës hetimore. Fillimisht, pjesëtarët e policisë kanë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për sigurimin dhe ekzaminimin e vendit të ngjarjes duke angazhuar njësitë e specializuara të krim-teknikës për shikimin e vendit të ngjarjes.

Ai theksoi se si rezultat i shikimit te vendit të ngjarjes dhe mbledhjes se gjurmëve, nga njësitet e specializuara janë kryer një sërë veprimesh, duke grumbulluar gjurmë dhe mikrogjurmë te cilat janë dërguar në laborator për ADN-në, janë marrë gjurmë të gishtave dhe gjurmë të tjera në vendin e ngjarjes.

Me qëllim të koordinimit më të mirë të veprimeve hetimore, operative, analitike dhe të mbështetjes së nevojshme administrative, në momentin që jam njoftuar nga drejtori i përgjithshëm, kam kërkuar nga ai që ky rast të trajtohet me prioritet absolut.

Si rezultat i kësaj, drejtori i përgjithshëm i Policisë, në bazë të kompetencave ka angazhuar një ekip të hetuesve policor profesional për zbardhjen sa më të shpejtë të të gjitha rrethanave, motiveve, dhe implikimeve të tjera ne lidhje me të dyshuarit, arrestimin dhe sjelljen e tyre para drejtësisë. Prej momentit kur ka ndodhur rasti, janë zhvilluar hetime intensive nga zyrtar policor nën udhëheqjen e prokurorit. Rasti është nën mbikëqyrjen e prokurorit ndërkombëtar nga prokuroria speciale dhe janë duke u zhvilluar hetime ndaj disa të dyshuarve të mundshëm.

Ne vazhden veprimeve hetimore, Policia e Kosoves me datën 2 qershor 2009, gjatë një operacioni në pikën kufitare të Hanit të Elezit ka arrestuar tre persona meshkuj, kurse dy femra janë shoqëruar në polici. Për shkak të përcjelljes për një kohë të gjatë nga policia të të dyshimëve, ne momentin që ata kanë tentuar për t'u larguar nga Kosova, Policia ka zhvilluar operacionin e kapjes së tyre në pikën kufitare të Hanit të Elezit, Arrestimi është bërë me dyshimin se këta persona janë të involvuar në aktivitete kriminale, ndërkohë janë arrestuar edhe dy meshkuj tjerë të cilët kishin identitet të rrejshëm, si dhe janë shoqëruar edhe dy femra që ishin së bashku në automjet. Në lokacionet e personave të arrestuar është kryer kontrollimi i shtëpive, ku është konfiskuar një armë automatike AK-47, një maskë dhe dëshmi të tjera.

Ministri Pajaziti lidhur me përgjegjësit menaxheriale tha se në bazë të Ligjit të Policisë, drejtori ka pavarësi operacionale në menaxhimin dhe udhëheqjen e Policisë së Kosovës dhe si rezultat ai ka themeluar këtë grup të veçantë për të mbështetur hetimet që janë duke u zhvilluar nga hetuesit bartës të rastit. Gjithashtu, në këtë rast drejtori i përgjithshëm ka suspenduar 5 zyrtarë policorë, nga të cilët disa kanë qenë përgjegjës për sigurinë e objektit, ndërsa të tjerë kanë pasur përgjegjësi menaxheriale.

Ai tha se në bazë të Ligjit për Inspektoratin Policor, Inspektorati është i autorizuar të zhvillojë inspektime dhe të raportojë mbi punën dhe efikasitetin e punës së policisë, si dhe ka autoritet të hetojë shkeljet e rënda disiplinore, pra të zhvillojë procedurë hetimore administrative. Inspektorati është duke zhvilluar procedurën e inspektimit dhe të hetimit administrativ në bazë të autorizimeve që ka dhe varësisht nga zhvillimi i këtyre aktiviteteve, do të dalë me rekomandime konkrete për rastin.

Ai theksoi se rasti i vjedhjes në dhomën e dëshmime padyshim ka dëmtuar rënd imazhin e Policisë së Kosovës. Që prej fillimit kam kërkuar nga Menaxhmenti i Policisë së Kosovës trajtimin e këtij rasti me prioritet absolut, duke u fokusuar në dy aspekte, në adresimin e

përgjegjësisë penale, duke zbardhur në tërësi rastin dhe duke sjellë para drejtësisë kryerësit e kësaj veprë të rëndë penale; si dhe adresimin e përgjegjësisë menaxheriale. Ministri Pajaziti, para deputetëve tha se në zbardhjen e rastit janë angazhuar hetuesit dhe zyrtarët policorë më të dëshmuar të Policisë së Kosovës, të cilët po punojnë me profesionalizëm dhe përkushtim të lart për zbardhjen e rastit.

Ai falënderoi deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës për interesimin e treguar dhe mbështetjen e ofruar në zbardhjen e këtij rasti, duke ju siguruar se ky rast nuk do të mbetet i harruar dhe me hetime të pafundme. Zbardhja e rastit dhe sjellja para drejtësisë e të gjithë atyre që kanë qenë të përfshirë në këtë vepër penale dhe në baze të raporteve dhe dinamikës aktuale të procesit hetimor ju siguroj se së shpejti priten rezultate konkrete në këtë drejtim.

Kryetari i Komisionit për Penë të Brendshme dhe Siguri, **Rrustem Mustafa**, tha se në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, Komisioni parlamentar për Punë të Brendshme dhe Siguri, si komision funksional, ka shqyrtuar në disa mbledhje rastin e rëndë të vjedhjes së dëshmive në dhomën e provave që ka ndodhur më 25 prill 2009 në objektin komandues kryesor të Policisë së Kosovës.

Ka qenë dhe është evidente shqetësimi i opinionit publik pas lajmërimit në media lidhur me vjedhjen në polici dhe konfuzionit të krijuar nga heshtja, joprononcimi nga përgjegjësit brenda strukturave të Policisë së Kosovës për informim të drejtë lidhur me rastin.

Ai theksoi se objekti është siguruar nga dy sisteme të sigurisë : nga Kompania Private e Sigurimit -për lokalet e Prokurorisë, dhe nga Sigurimi i Policisë së Kosovës -për lokalet e Policisë së Kosovës, ndër të tjera, edhe dhoma e provave.

Pas refuzimit të ftesës për dëgjim publik nga ana e drejtorit të përgjithshëm, Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri me datën 18.5.2009, nxjerr rekomandimin se kontrolli parlamentar dhe mbikëqyrja demokratike ndaj Policisë së Kosovës duhet të fuqizohet. Mosardhja e drejtorit të Policisë para Komisionit është vlerësuar si mos gatishmëri për t'iu nënshtruar kontrollit parlamentar.

Po ashtu, ai theksoi se vrasja e dy qytetarëve në stacione të Policisë në Pejë, në këtë rast u hesht në ndërmarrjen e disa masave të brendshme administrative dhe ngjarja kaloi në harresë, vrasja e dy qytetarëve në protestat e lëvizjes Vetëvendosje, më 10 shkurt 2007, vrasja e zyrtarit të Policisë së Kosovës në komandën kryesore të policisë, me datë 28 janar 2008 gjatë shërbimit në punë dhe për këtë rast nuk kemi rezultate të hetimit dhe, për çudi, rasti është pezulluar, për kundër rastit të rëndë me pasoja të dukshme dhe sidomos ngecja në llogaridhënie nga autoritetet e Policisë së Kosovës, i cili institucion është segmenti më i rëndësishëm i Sigurisë së Qytetarëve, prandaj duhet të ndodhin ndryshime në lidhshëm me Policiën e Kosovës dhe atë sipas programit të reformave të Policisë së Kosovës, duke iu referuar standardeve më të larta evropiane.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Adem Grabovci**, tha se Kosova si shtet i pavarur, sovran dhe multietnik me institucionet e veta demokratike, dëshmoi përgjegjësinë dhe seriozitetin adekuat në situatat më të rënda nëpër të cilat kaluam në periudhën e pas pavarësisë së vendit deri më sot. Mekanizmat e sigurisë në Kosovë të para pavarësisë së vendit si Shërbimi Policor i Kosovës, Trupat Mbrojtëse të Kosovës me seriozitet dhe përgjegjshmëri institucionale arritën jo vetëm të ballafaqohen me situatat e ndryshme. Për të gjitha këto suksese krahas suksesit të vendorëve, nuk mund të mbetet pa u përmendur edhe kontributi i bashkësisë ndërkombëtare, për çka ne u jemi mirënjohës.

Rasti i vjedhjes së dëshmimeve në dhomën e provave në pikë të ditës është një akt qyqar dhe i lig, Grupi Parlamentar i PDK-së iu jep përkrahje organeve të hetuesisë që ta zbulojnë rastin. Përgëzoi ministrin e Punëve të Brendshme, përmes tij edhe gjithë Policinë e Kosovës, për suksesin e arritur në arrestimin e mbeturinave të shërbimit sekret të Serbisë në Kosovë që tentonin me para dhe shantazhe të njollosin luftën tonë çlirimtare.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Eqrem Kryeziu**, tha se mendimi i Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri ka qenë i saktë lidhur me zhvillimet e fundit në polici, andaj ju siguroj se të gjitha autoritet e Kosovës e dënojnë këtë akt, ku aspekti i sigurisë, sundimi i ligjit dhe zhvillimi i vendit si shtet demokratik me perspektivë euroatlantike janë të lidhura ngushtë mes veti. Nxitja e investimeve të huaja dhe depërtimi i kapitalit të huaj kanë si parakusht sigurinë dhe stabilitetin politik dhe ekonomik të vendit. Andaj, klasa politike dhe institucionet kanë përgjegjësi të japin kontributin maksimal në shërbim të këtij qëllimi.

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, the se kontrollin e policisë në një vend demokratik e bën ministri e ministrin e kontrollin ky kuvend, i cili është zgjedhur nga populli. Gjendja e krijuar fillimisht e shkakton mosbesimin tonë dhe mosbesimin e qytetarëve në forcat e rendit dhe në polici. Shërbimi Policor i Kosovës, tani Policia e Kosovës ka qenë institucioni më i besuar prej institucioneve vendore, institucion me të cili jemi mburrë secili prej nesh. Tani është rrënuar seriozisht ky besim, jo vetëm vendor, por është rrënuar seriozisht edhe besimi i partnerëve tanë, të cilët kanë investuar bashkë me ne në ndërtimin e këtij shërbimi. Kjo është pasojë që qarqet e organizuara kriminale sot shumë saktë mund të besojnë që asgjë në Kosovë nuk është e pamundshme, aq më tepër se mungon një vullnet politik

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Ibrahim Makolli**, tha se institucioni i Policisë së Kosovës është pasqyra e një vendi, andaj vjedhja në dhomën e provave është ngjarja më e rëndë dhe e humb imazhin e policisë së Kosovës. Duhet të potencohet që vjedhja në dhomën e dëshmimeve është rast shumë i rëndë, i cili besoj se duhet të shfrytëzohet në radhë të parë për të bërë analiza të thella lidhur me gjendjen në Policinë e Kosovës, si në kuadro po ashtu edhe në edukimin, trajnimin e tyre profesional dhe të kapaciteteve teknologjike me qëllim që të jenë më efikas. Shume pjesëtarë të Policisë së Kosovës janë për respekt dhe ne nëse nuk kemi arritur t'i përkrahim financiarisht, atëherë duhet t'u japim përkrahje morale. Kërkoj me ngulm që hetimet duhet të vazhdojnë deri në fund me

bindje që në Policinë e Kosovës ka njerëz të aftë dhe me përkushtim për ta kryer detyrën e vet. Ky rast duhet të shfrytëzohet në radhë të parë për zbatimin sa më të shpejtë në tërësi të Ligjit mbi Policinë e Kosovës, përfundimin e procesit të reformave në të gjitha nivelet e policisë, ngritjen e profesionalizimit të Policisë së Kosovës përmes edukimeve dhe trajnimeve të specializuara në bazë të standardeve ndërkombëtare.

Në emër të Grupit Parlamentar LDD-së, **Lulzim Zeneli**, tha se vjedhja në dhomën e provave është me shume se sa një hajni dhe akt qyqar, por ju duhet të na siguronit se vjedhja në dhomën e provave nuk ka implikime politike dhe në atë vend ku vidhet policia, nuk ka demokraci. Moskoordinimi dhe kompleksiteti i raporteve të krijuara edhe i çoroditur ndërmjet Policisë, Qeverisë, Kuvendit, Komisionit Parlamentar për Siguri, në esencë përmban thelbin e problemit. Vjedhjet dhe plaçkitjet ndodhin në çdo vend demokratik, po këto ndodhin nga aktorët e brendshëm dhe aktorët e jashtëm. E kjo është përgjegjësia e juaja që ta ndriçoni rastin. Përgjegjësia tek menaxhimi i situatës duhet të jetë transparente, cilët janë hapat dhe çka është në fund rezultati. Debatimi sot ka filluar për këtë çështje, por gabojnë ata të cilët mendojnë se ky debat rreth kësaj çështjeje do të mbyllet. Ky debat do të jetë prezent derisa të mos ndriçohet rasti.

Në emër të Grupit Parlamentar të “7+”, **Xhezair Murati**, tha se në mbështetje të masave të ndërmarra nga Ministria dhe Shërbimi Policor i Kosovës, si me zgjerimin e sigurt të hetimit, ne shpresojmë se autorët do të sillen para drejtësisë. Kjo është në të njëjtën kohë një këshillë të madhe dhe inkurajim se nuk do të lejohet paraqitja e incidenteve të ngjashme në të ardhmen.

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, **Sllobodan Petroviq**, tha se situata në Policinë e Kosovës është vërtet shqetësuese, duke marrë parasysh se policia nga komuniteti serb ende nuk është kthyer në punë. Ne shpresojmë që me kthimin e tyre, sado pak do të jepet mundësi që ky krim të zbardhet sa më parë.

Në debat morën pjesë edhe këta deputetë: Naim Maloku, Hajredin Kuqi, Rustem Mustafa, Emrush Xhemajli, Shkumbim Demaliaj, Gani Geci, Zylfije Hundozi, Numan Baliq, Naser Rugova, Edita Tahiri, Adem Salihaj, Gani Koci, Esat Brajshori, Xhylnaze Sylaj, Armend Zemaj, Donika Kadaj-Bujupi, Haset Cakolli, Riza Smaka, Ramadan Avdiu, Ibrahim Selmani, Njomza Emiri, Hydajet Hyseni, Hajdin Abazi, Mark Krasniqi dhe Bahri Hyseni, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Në fund, ministri për Punë të Brendshme, **Zenun Pajaziti**, tha se sot nuk ju kam sjellë më shumë informata, që e dëmtojnë procesin e hetimit, po ju siguroj që ju kam sjellë një gatishmëri personale, edhe të Qeverisë, për të vazhduar hetimet deri në fund jo vetëm këtë rast, por edhe për rastet tjera, për të luftuar krimin në përgjithësi. Ka edhe pakënaqësi në këtë proces. Ne nuk mund t'i evitojmë dhe nuk do të mund t'i evitojmë të gjitha dobësitë ose mangësitë që i kemi gjetur në një proces që ka qenë i gjatë, në një sistem të krijuar me mbështetjen ndërkombëtare, shpeshherë me praktika të ndryshme nga vende të ndryshme dhe shpeshherë edhe me mungesë të kapaciteteve tona të menaxhimit. Ju them që na kanë mbetur edhe një varg çështjesh që lidhen me reformat,

kemi përmbyllur pjesën e legjislacionit dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kemi aprovuar legjislacion që përfshinë këtë sferë kaq të rëndësishme.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 17: 43 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**